

FORMAT RAPORTIMI I KOMITETIT RAJONAL TË LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE, NË ÇDO QARK

Për përgatitjen e raportit të Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave, në çdo qark, çdo Komitet duhet të ketë në vëmendje:

1. Raporti i përgatitur nga Komiteti duhet të jetë produkt i punës së të gjithë anëtarëve të Komitetit.
2. Raportimi duhet të jetë periodik (si rregull çdo 3 muaj) dhe përmbajtja e raportit duhet të japë informacion vetëm për periudhën për të cilën raportohet.
3. Raporti duhet të përmbajë informacion për zbatimin e planit të veprimit të Komitetit.
4. Komiteti përgatit edhe raporte për periudha më të gjata 6-mujore dhe 1-vjeçare.
5. Raporti duhet të përmbajë informacion të përpunuar dhe të organizuar mirë, si nga pikëpamja e strukturës ashtu edhe e përmbajtjes.
6. Gjuha e përdorur duhet të jetë e qartë, e thjeshtë dhe e kuptueshme.
7. Duhet evituar në maksimum përsëritjet dhe përsëritjet e tepërta që nuk japin informacion.
8. Raporti duhet të përcillet pranë zëvendësministrit të Punëve të Brendshme/Koordinatorit Kombëtar për Çështjet e Luftës Kundër Trafikimit të Personave, domosdoshmërisht në rrugë zyrtare dhe në format elektronik në adresat përkatëse. Ky raport i dërgohet, për dijeni, të gjithë anëtarëve të Komitetit, përfshirë edhe shoqërinë civile.
9. Raporti duhet të hartohet dhe të përcillet në formën e një shkrese zyrtare e firmosur nga kryetari i Komitetit me datë dhe me numër protokollit të institucionit që e dërgon.
10. Struktura e raportit:
 - a) Një përmbledhje e veprimtarisë së Komitetit për periudhën që raportohet. Në këtë përmbledhje shkurtimisht duhet të përmenden aktivitetet e organizuara nga Komiteti, disa të dhëna statistikore apo tregues të arritjeve dhe rezultateve kryesore.
 - b) Të dhëna statistikore të përditësuara për periudhën që raportohet. Të dhënat duhet të përfshijnë informacion të përpunuar të ardhur nga të gjitha strukturat që janë pjesë e Komitetit. Të dhënat statistikore duhet të përmbajnë informacion për:
 - i. rastet e evidentuara nga Policia dhe të gjithë aktorët e tjerë;
 - ii. personat e identifikuar si viktimë/viktima të mundshme të trafikimit;
 - iii. grupet dhe individët e rrezikuar nga trafikimit si: fëmijë të paregjistruar, fëmijë të rrugës, fëmijë që kanë braktisur shkollën, fëmijë jetim, komuniteti rom, familje në vështirësi ekonomike dhe me probleme sociale, familje me kryefamiljarë grua, gra të divorcuara etj.;
 - iv. niveli i papunësisë për të gjitha kategoritë (gra, vajza dhe burra);

- v. ndihmën dhe asistencën e dhënë për periudhën që raportohet;
 - vi. kapacitetet e shtuara për ofrimin e shërbimeve, nëse ka etj.
-
- c) përshkrim i aktiviteteve dhe veprimtarive kryesore të zhvilluara nga komiteti, strukturat përbërëse dhe aktorë të tjerë.
 - ç) planet për të ardhmen.
 - d) probleme, pengesa dhe vështirësi të evidentuara gjatë punës së Komitetit.
 - dh) sugjerime dhe rekomandime.